

Efiçienca e buxhetit të Bashkisë Devoll (Viti 2019)

1. Analiza e parashikimit të të ardhurave për vitin fiskal 2019

Studimi ka për qëllim të analizojë efiçencën dhe shpenzimet e të ardhurave për vitin 2019, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.

Projekti financohet nga UNDEF dhe zbatohet nga ARZH (Agjensia Rajonale e Zhvillimit) dhe EIC (Economic Intelligence Center) Korçë.

Bazuar në Ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë. Ndërsa transfertat janë fonde, të cilat u delegohen bashkive sipas parashikimeve ligjore dhe funksioneve shtesë që mori pushteti vendor nga Reforma Administrative Territoriale.


Më poshtë jepen të ardhurat totale të bashkisë:

Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve

Burimet e financimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
Transferta e pakushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të lirë)	183,359	1,780,184	40%
Transferta e kushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	83,497	810,650	18%
Transferta specifike	94,259	915,136	21%
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë)	81,934	795,476	18%
Të ardhura të tjera (të ardhura nga institucionet që Bashkia ka nën varësinë e saj)	12,298	119,398	3%
Total	455,347	4,420,845	100%

Burimi: Bashkia Devoll, llogaritje EIC

Figura 1. Të ardhurat totale, Bashkia Devoll 2019



Burimi: Bashkia Devoll, llogaritje EIC

2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Devoll për vitin fiskal 2019

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fondeve, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përse shpenzohen nga bashkia?


Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2019. Më poshtë po japim tabelën përmbljedhëse të shpenzimeve:

Tabela 2. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale

Emërtimi i shpenzimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
Shpenzime Paga+Sig.Shoqërore	196,032	1,903,223	43
Shpenzime Operacionale	164,180	1,593,981	36
Shpenzime Kapitale	120,388	1,168,816	26
TOTALI	480,600	4,666,019	106


Burimi: Bashkia Devoll, llogaritje EIC

Figura 2. Shpenzimet totale si raport mbi të ardhurat totale



Burimi: Bashkia Devoll, llogaritje EIC

Figura 3. Shpenzimet për paga/sig. shoqërore si raport mbi të ardhurat lokale



Burimi: Bashkia Devoll, llogaritje EIC